

Aleksandra Filipović
Milica Matanović
Ana Perunović-Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS 3

MANUALI PËR
MËSUESE/MËSUES

Kultura muzikore për klasën
e tretë të shkollës fillore



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2026

Aleksandra Filipović
Milica Matanović
Ana Perunović-Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS 3

Kultura muzikore
për klasën e trete të shkollës fillore

MANUALI për
mësuese/mësues

Botuesi
Enti i Teksteve dhe i Mjeteve
Mësimore – PODGORICË

Për botuesin
Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor
Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës
Lazo Leković

Redaktore e botimit
Bilana Miranović

Redaktor në gjuhën shqipe
Dimitrov Popović

Recensentë
Dr. Vesna Vučinić
Mr. Natasha Popović
Mr. Vera Marković
Fran Vulaj
Radmilla Bajković

Përkthyes
Luigj Dedvukaj, arsimtar i lëndës

Korrektura
Luigj Dedvukaj

Ilustrimet
Maria Popović

Disenjoja dhe faqosja
Millena Llakićević

Faqosja
Marijana Simonović

Redaktore teknike
Dajana Vukčević



CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2581-6
COBISS.CG-ID 36998404

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me Vendimin nr. 05/3-01-119/24-5099/7 të datës 16. 7. 2024,
e ka miratuar këtë Manual për përdorim në shkollën fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2026

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	6
Udhëzime metodike për realizimin e orës mësimore	8
Klasa e tretë.....	10
Himni i Malit të Zi.....	11
Çfarë kemi dëgjuar e mësuar?.....	12
1. TINGUJT (TONET) DHE TERMAT-NOCIONET MUZIKORE	14
Shiu.....	14
Toni.....	15
Përsëritja.....	16
Orkestra.....	17
Pianisti.....	19
Kompozitori/Kompozitorja.....	20
Gjeje kush është?.....	21
2. THESARI POPULLOR.....	22
Duke ecur pranë Luboviqit.....	22
Roza thurte.....	23
Kërcimtarja.....	25
Ninanana.....	26
Në qytetin Buda.....	27
A i keni dëgjuar këto?.....	29
3. KËNDOJMË PËR NATYRËN DHE SHOQËRINË.....	31
Këngë numërimi e vjeshtës.....	31
Kënga e vjeshtës.....	33
Shtëpiza.....	34
Poeti i qiellit.....	36
Babi.....	37
Vini Pu	39
Muzikantët e Bremenit.....	40
Ruaje Planetin	43
Gjyshja Marë.....	44
Gjyshi.....	46
Kush po këndon?.....	47
4. NË BOTËN E INSTRUMENTEVE.....	48
Klarineta.....	48
Violonçeli.....	49

Harpa.....	50
Miu në teatër – tregim muzikor.....	51
5.MËSOJMË TË LUAJMË.....	53
Nëna ime.....	53
Miu dhe pelushi.....	54
Plak prej bore.....	56
6. HAPËSIRA PËR DËGJIMIN E MUZIKËS (DËGJIMORJA).....	58
Zhanri muzikor.....	58
Në krahët e muzikës së filmit.....	59
LITERATURA.....	61

PARATHËNIE

Të nderuara mësuese dhe të nderuar mësues, para jush ndodhet **manuali** për klasën e tretë të shkollës fillore, i cili përfshin rezultatet e parashikuara në Programin mësimor për lëndën përkatëse. Manuali është i ndarë në gjashtë kapituj me tema të ndryshme, të cilat ndjekin në mënyrë të përputhshme përmbajtjen e tekstit mësimor.

Në fillim të vitit shkollor, do t'u kujtojmë nxënësve njohuritë e fituara në klasën e dytë.

Në kapitullin e parë, **Tingujt dhe nocionet-termat muzikorë**, nxënësit dhe nxënëset fitojnë njohuri për terma-koncepte të reja të gjuhës muzikore, përmes këngëve autoriale të krijuara në mënyrë që secila të trajtojë një element muzikor të veçantë (si pauza, përsëritja, dirigjenti). Në kapitullin **Thesari popullor**, trajtohen këngë popullore nga Mali i Zi dhe rajonet përreth.

Temat e larmishme të kapitullit **Këndojmë për natyrën dhe shoqërinë** do t'u duken veçanërisht interesante nxënësve dhe nxënëseve, sepse përveç këngëve, do të mësojnë edhe disa lojëra muzikore. Në kapitullin **Në botën e instrumenteve**, nxënësit dhe nxënëset njihen edhe me tri instrumente të reja, ndërsa në fund të kapitullit, përmes një tregimi muzikor, përforcojnë në mënyrë dëgjimore njohuritë për timbrin (ngjyrën) e disa instrumenteve muzikore.

Kapitulli i ri **Mësojmë të luajmë** i fut nxënësit dhe nxënëset në botën e krijimit dhe të interpretimit të pavarur të tingujve me instrumente. Në klasën e dytë ata kanë mësuar të krijojnë dhe të strukturojnë ritme, ndërsa tani do të kenë mundësi të krijojnë edhe muzikë. Në fund, kemi planifikuar dëgjim përjetues të muzikës dhe Ditarin e dëgjimit, që gjendet në pjesën e titulluar **Hapësira për dëgjimin e muzikës (Dëgjimorja)**. Përveç përjetimit emocional të muzikës, nxënësit dhe nxënëset do të kenë rastin të njihen edhe me konceptin e **zhanrit muzikor**, si dhe me shembuj të muzikës filmike dhe asaj popullore (popullarizuar-pop).

Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të aftësive muzikore me përzgjedhjen e kujdesshme të këngëve të numërimit, lojërave-vallëzimeve muzikore, shembujve për dëgjim dhe për interpretim ritmik ku do të kontribuojnë në realizimin e suksesshëm të orëve mësimore. Në këtë manual do të gjeni shembuj të shumtë praktikë dhe përshkrime aktivitete, pasi çdo temë mësimore është trajtuar në mënyrë të detajuar, me rezultatet e pritshme, metodat e punës dhe materialet përkatëse, si: partitura të këngëve, përshkrime të lojërave dhe këngëve të numërimit, kurse shembujt tingullorë (incizimet) do t'i gjeni përmes **QR-kodit**. Gjatë përgatitjes dhe mbledhjes së materialit jemi përpjekur që ai të jetë krijuar, novator dhe nxitës i imagjinatës së fëmijëve, duke zgjuar te ta impulsin për lëvizje, përmes interpretimit të ritmit dhe këndimit të melodisë.

Udhëzimet metodike të manualit janë në përputhje me parimet bazë të metodologjisë së mësimdhënies së kulturës muzikore dhe kanë karakter të përgjithshëm, ndërsa janë të përpunuara në detaje brenda njësive mësimore. Theksojmë se renditja e temave mësimore në tekstin shkollor dhe në manual nuk ndjek planin e punës fiks, por mësimdhënëset e

mësimdhënësit janë të lirë të zgjedhin dhe të përcaktojnë kohën dhe mënyrën e realizimit të secilës temë.

Për përpunimin e temave të reja mësimore është parashikuar një orë mësimore. Sidoqoftë, në varësi të aftësive, interesimit dhe arritjeve të nxënësve, temat mund të shtrihen-përpunohen në më shumë orë.

Besojmë se ky manual do të jetë një **mjet i çmuar** për ju dhe do të ndihmojë në krijimin e një ambienti pune imagjinuese dhe krijuese. Ju urojmë punë të mbarë dhe të suksesshme!

Autoret

UDHËZIME METODIKE PËR REALIZIMIN E ORËS MËSIMORE

Kur bëhet fjalë për këngët që do të këndohen, edhe në këtë klasë, ashtu si në klasën e mëparshme, ato mësohen vetëm me anë të veshit muzikor – përmes dëgjimit. Në disa pjesë-hapa të përgatitjeve mësimore kemi theksuar vetëm që kënga të punohet sipas procedurës metodike të përpunimit të këngës me anë të veshit - të mësuarit përmes dëgjimit, ndërsa metodologjia përkatëse është përshkruar më poshtë. Siç është e njohur, kjo procedurë metodike zhvillohet përmes fazave të mëposhtme:

- krijimi i atmosferës së përshtatshme për punë
- nxitja e mendimit dhe udhëheqja drejt temës së këngës (këtu përdoret shpesh metoda “brainstorming”)
- interpretimi i këngës (mësuesja/mësuesi)
- analiza e tekstit të këngës
- këndimi i këngës pjesë-pjesë, zakonisht varg pas vargu (ose, nëse kënga është e shkurtër – strofë pas strofe)
- këndimi i këngës nga fillimi deri në fund.

Pasi kënga mësohet, është në dorën e mësueses/mësuesit të vendosë nëse nxënësit/nxënëset do ta këndojnë individualisht, në çift, në grup ose sipas rreshtave. Në këtë moshë, Programi parashikon këngë me diapazon deri në pesë tinguj, çka është marrë në konsideratë edhe gjatë përzgjedhjes së këngëve për mësim me anë të veshit – përmes dëgjimit.

Te rezultati mësimor **“njohja vizuale dhe përmes dëgjimit e instrumenteve”**, mbështetemi te instrumentet që nxënësit kanë mësuar në klasën e dytë, prandaj, mësimi nis me shembuj të njohur. Siç kemi theksuar disa herë, mënyra më e mirë është të kemi instrumentin fizikisht në klasë (“live”), sepse kështu nxënësit e mbajnë mend më mirë dhe ora mësimore është më e suksesshme, nëse kemi një solist instrumentist, i cili do të demonstrojë të gjitha mundësitë teknike të instrumentit që po mësohet. Në këtë klasë mësohen violonçeli, klarineta dhe harpa. Duke qenë se në ciklin e parë nxënësit dhe nxënëset njihen me shumë instrumente, është e këshillueshme të planifikohen vizita në qendra kulturore-informative, teatro, shkolla të muzikës, ku mund të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me orkestrën dhe instrumentet. Gjithashtu, është e dëshirueshme të organizohet një vizitë në Qendrën muzikore që ndodhet në Podgoricë.

Rezultati mësimor që lidhet me terma-**konceptet themelore të gjuhës muzikore** na ofron shumë mundësi për realizimin e orëve krijuese dhe me imagjinatë të pasur. Për këtë qëllim, përveç shembujve për dëgjim, kemi përgatitur ritmograme të ndryshme, si dhe shembuj muzikorë interesantë dhe me vlerë të qartë didaktike.

Kur flasim për dëgjimin e muzikës, përzgjedhja e shembujve në këtë klasë është disi më e ndryshme: përveç muzikës artistike (klasike), nxënësit dëgjojnë edhe shembuj nga muzika filmike, muzika popullore (pop) dhe muzika për vallëzim. Vizitat e planifikuara në kinema duhet të shfrytëzohen që, në orën e kulturës muzikore, nxënësit të flasin, të mendojnë, të vizatojnë dhe të shprehin përshtypjet e tyre për muzikën e filmit që kanë parë. Aktivitetet e nxënësve duhet të bazohen në krijimin e tregimeve, vizatimeve, lëvizjeve, përshkrimit e ndjenjave dhe

përjetimeve gjatë dëgjimit të muzikës. Duhet të nxiten të japin përgjigje të ndryshme, edhe nëse jo të gjitha janë të sakta apo të parashikuara – ajo që ka rëndësi është mënyra e të menduarit. Është me rëndësi që nxënësit të mund të identifikojnë karakterin e pjesëve muzikore që dëgjojnë me karakterin e një shoku/shoqeje, një kafshe shtëpiake, një dukurie natyrore etj. Kjo metodë është shpjeguar në mënyrë të detajuar në përgatitjet mësimore.

Pas disa kapitujve të caktuar ndodhen edhe **“Gjëegjëza muzikore”**, të cilat janë menduar si një formë verifikimi njohurish. Ato përmbajnë detyra që kërkojnë në mënyrë argëtuese nga nxënësit të lidhin, plotësojnë, vizatojnë dhe në këtë mënyrë të përforcojnë njohuritë e fituara.

Klasa e tretë

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 82$

C C C F D6 G

Mir' se er - dhët n'klas' të tre - të, thon' se je - ni të vër - te - të..

3 F C

Ne tash - më ke - mi ca di - je, më - su - am e - dhe t'le - xoj - më.

5 F Eb F C Bb C

I shkru - ajm' bu - kur dhe shkro - njat, a - ven - tu - rë tash - më e re.

7 G F C

Kën - doj, dë - gjoj e - dhe lu - aj, un' në shko-llë du - a të shkoj.

Rezultatet e të nxënët

Gjatë mësimt nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike me diapazon deri në pesë tinguj-tone,
- të formësojë zërin e vet për këndim dhe të njohë drejtimin e lëvizjes së zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje), duke korrigjuar intonacionin gjatë interpretimit.

Incizimi (shënime tingullore): Këngë artistike – “Klasa e tretë”



Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bisedojnë për mënyrën se si e kanë kaluar pushimin veror, nëse u kanë munguar shokët, shoqëria dhe shkolla. Rikujtojnë këngët që kanë mësuar në klasën e dytë, flasin për temat e tyre dhe zgjedhin një këngë për ta përsëritur, e cila do të shërbejë edhe për ngrohje të zërit.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë tekstin mësimor dhe vërejnë se tani përmes tij i udhëheqin personazhet Mila dhe Simo, të cilët paralajmërojnë një këngë të re. Së bashku me mësuesen/mësuesin përshkruajnë piktogramet dhe më pas analizojnë tekstin e këngës “Klasa e tretë”.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi e punon këngën sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit – përmes dëgjimit.
- Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset interpretojnë këngën e mësuar individualisht, në çift dhe në grup, sipas zgjedhjes së tyre. Gjatë këndimit, formësojnë zërin dhe përmirësojnë interpretimin. Ata gjithashtu njohin drejtimin e lëvizjes së zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje).

Himni i Malit të Zi

Oj svijetla majska zoro

(O, agim i ndritshëm maji)



Vërejtje: Himni i Malit të Zi i përkthyer në shqip ndodhet në tekstin mësimor të klasës së tretë në faqen 6.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndoje himnin shtetëror,
- të njohë përmes dëgjimit himnin shtetëror.

Incizimi (shënime tingullore): Himni i shtetit “O, agim i ndritshëm maji”

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bëjnë nxehjen-ngrohjen vokale duke kënduar këngën tashmë të mësuar Klasa e tretë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë himnin e shtetit të Malit të Zi dhe e njohin atë. Bëjnë bisedë për kuptimin dhe rëndësinë e himnit shtetëror, rikujtojnë në çfarë rastesh këndohet dhe si duhet të sillet secili gjatë interpretimit të tij. Mësuesja/mësuesi i udhëzon të shikojnë tekstin e himnit në tekstin mësimor dhe më pas e analizojnë së bashku.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit – përmes dëgjimit. Nxënësit dhe nxënëset e dëgjojnë me vëmendje dhe e përsërisin këngën, duke e mësuar pjesë-pjesë.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë himnin, duke përmirësuar intonacionin gjatë interpretimit. Interpretojnë këngën individualisht ose në grup.

Çfarë kemi dëgjuar e mësuar?

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë përmes dëgjimit dhe pamjes, si dhe të emërtojë timbrin e kitarës, flautit dhe fizarmonikës,
- të këndoje këngë artistike dhe popullore,
- të njohë përmes dëgjimit shembujt muzikorë të propozuar.

Incizimi (shënimet tingullore): F. Tarrega: “Kujtimet e Alhambres”

K. Sen-Sans: Zogjtë

A. Pjacula: Libertango

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit bëjnë nxehjen-ngrohjen vokale me këngën Klasa e tretë. Bisedojnë për tekstin e këngës. Diskutojnë se çfarë kanë mësuar nga lënda Kulturë Muzikore në klasën e parë dhe të dytë.

2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesi/Mësuesja i udhëzon nxënësit dhe nxënëset të hapin tekstin mësimor në faqen 7. Ata vëzhgojnë me kujdes ilustrimet dhe përshkruajnë pamjen e instrumenteve, i njohin vizualisht dhe rikujtojnë njohuritë e fituara në klasën e dytë (realizojnë detyrën nr. 1 – *Emërto instrumentet*).
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi lëshon incizimet (shembujt tingullorë): F. Tarrega: Kujtimet e Alhambres, K. Sen-Sans: Zogjtë, A. Pjacula: Libertango, me detyrë që nxënësit të identifikojnë cilat instrumente kanë dëgjuar. Në tekstin mësimor, në faqen 7, realizojnë detyrën 2 duke lidhur ilustrimet me emrin e veprës muzikore të dëgjuar dhe/ose me QR kodin përkatës.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesja/mësuesi lëshon shembuj të muzikës për zë solo (fëmijëror) dhe për kor. Nxënësit dhe nxënëset i dëgjojnë me kujdes, me detyrë për të identifikuar llojet e zërave të dëgjuar. Më pas, në tekstin mësimor, realizojnë detyrën nr. 3, duke lidhur ilustrimin me titullin e veprës muzikore të dëgjuar / QR kodin.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset rikujtojnë dhe këndojnë këngë të mësuara në klasën e parë dhe të dytë (sipas zgjedhjes së tyre).

1. TINGUJ (TONET) DHE TERMAT - NOCIONE MUZIKORE

Shiu (A. Filipoviq)

Shi i i - mët bi - e n'qy - tet.
Pi - kon, tro - ket, dë - gjo - het leht'.
Hap - ni çad - rat tu - a - ja t'ver - dha, t'kal - tra,
Që t'mos i lag - ni ko - kat ngu - tu - ni, shpejt.

Rezultatet e të nxënët

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

— të përdorë në mënyrë të saktë konceptin e pauzës në muzikë.

Incizimi (shënime tingullore):

Kënga artistike "Shiu"

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bëjnë nxehjen vokale me një këngë tashmë të njohur. Bisedojnë për natyrën dhe dukuritë që ndodhin në të. Luajnë lojën Shiu dhe diskutojnë rreth tingujve që i shoqërojnë këto dukuri.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën Shiu. Pasi ta kenë dëgjuar të plotë, zhvillojnë një bisedë rreth tekstit të saj.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset e dëgjojnë përsëri incizimin (shembullin tingullor) të këngës, me vëmendje të veçantë ndaj pjesëve të tekstit: shi – i... i – mët... pi – kon... tro – ket... Vërejnë se pas këtyre rrokjeve ndodhin ndërprerje në të kënduar. Mësuesja/mësuesi shpjegon se këto ndërprerje në këngë dhe në muzikë quhen pauza.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesja/mësuesi fillon përpunimin e këngës sipas procedurës metodike me anë të veshit muzikor - përmes dëgjimit. Pasi ta kenë mësuar këngën, nxënësit e këndojnë individualisht ose në grup.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit shikojnë me vëmendje partiturën e këngës në tekstin mësimor dhe analizojnë pauzën e shënuar në shënimin pamor.

Toni

(A. Filipoviq)

$\text{♩} = 90$

D D A A D A D

Çfar' jan', çfar' jan' k'to to - ne? Haj - de na thu - aj ti ne!

5 D D A A D A D

Di - kush lu - an në to - ne, t'ul' - ta, t'bu - ta e t'the - lla,

9 D D A A D A D

var - gu prej di - sa to - nesh, a - jo ësh - të me - lo - di - a.

13 D D A A D A D

t'i kën - do - ni mun - de - ni, të shkur' - tra e të gja - ta.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të përdorë në mënyrë të saktë konceptin ton,
- të lidhë tekstin e këngës me melodinë.

Incizimi (shënime tingullore):

Kënga artistike "Toni"

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit rikujtojnë këngët që kanë mësuar në klasën e dytë: Më lart – e më poshtë dhe Shkurt – e gjatë. Nxënësit dhe nxënëset diskutojnë për lëvizjen e melodisë në këto këngë; kujtojnë shënimet pamore dhe, gjatë këndimit, e tregojnë lëvizjen e melodisë me dorë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi interpreton këngën Toni, ndërsa nxënësit dhe nxënëset e dëgjojnë me vëmendje. Pas dëgjimit, analizojnë tekstin e këngës në tekstin mësimor. Me ndihmën e mësueses/mësuesit, nxënësit dallojnë fjalën ton. Mësuesja/mësuesi demonstroi karakteristikat e tonit duke kënduar me lartësi, kohëzgjatje dhe intensitete të ndryshme dhe i udhëzon nxënësit drejt përfundimit se toni është çdo tingull i prodhuar nga një instrument ose nga zëri i njeriut. Çdo ton ka vetitë e tij: lartësinë, fuqinë (intensitetin), kohëzgjatjen, timbrin (ngjyrën e tingullit).
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit - dëgjimit. Nxënësit dhe nxënëset analizojnë dhe krahasojnë ndryshimet në lartësinë e tonit, përmes notacionit pamor (shënimeve) të melodisë, dhe lidhin tekstin e këngës me zhvillimin e melodisë.

Përsëritja

(A. Filipoviq)

$\text{♩} = 100$

Kur di - çka ti më - son, për - së - rit - je kër - kon,
di - sa he - rë ta prak - ti - kosh, ti do ta më - sosh.
Për - së - rit që të më - sosh, për - së - rit e mos rri bosh,
po për - s'ri - te për çdo di - të, s'do të lësh' bren - gën të të fik'.

Rezultatet e të nxënët

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

— të përdorë në mënyrë të saktë konceptin - shenjën për përsëritje.

Incizimi (shënime tingullore):

Kënga artistike *Përsëritja*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit e nxënëset përsërisin këngën e njohur për ngrohje zëri. Diskutojnë mënyrën se si mësojnë gjëra të reja, sa kohë u duhet për të mësuar, dhe nëse ushtrojnë dhe e përsërisin shumë herë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës, analizojnë tekstin, komentojnë dhe arrijnë në përfundimin se përsëritja është baza e mësimi të mirë.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit - dëgjimit. Pasi ta kenë mësuar këngën, mësuesi/mësuesja i udhëzon ata të vërejnë se disa pjesë të këngës përsëriten dy herë. Nxënësit vërejnë pjesën e këngës që përsëritet dhe e këndojnë atë. Mësuesi/mësuesja shpjegon se në muzikë përdoret një shenjë që tregon se një pjesë duhet përsëritur dy herë. U tregon se si duket shenja dhe u shpjegon se si quhet-u shpjegon emrin e saj.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesi/mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Nxënësit dhe nxënëset këndojnë këngë së bashku, e kur të arrijnë te repeticioni-pjesa e përsëritur, grupi i parë e këndon atë herën e parë, ndërsa grupi i dytë herën e dytë.

Orkestra

(M. Matanoviq)

Ven - do - sën vë - llez' - rit or - kes - tër gaz - mo - re,

5 ten - xhe - ret plot ngjy - ra, me vrap pas ty - re Pav - li.

9 Mu - zi - ka që lu - ajn' kur bij - në në gju - më,

13 me mu - zik' t'fi - lloj - në, të kri - ju - ar në çast.

17 Ci - lin zgjedh Vik - to - ri, me lu - gë po lu - aj - në,

21 të gjith' kët' e di - në, pa - ra - qi - tet hesht - ja.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimet nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë dhe ekzekutojë këngën e numërimit (në dy tone), duke përdorur elemente shprehëse;
- të luajë në instrumentet ritmike të instrumentariumit Orf;
- të performojë koreografi të thjeshta në lojërat me këndim.

Incizimi (shënime tingullore):

A. Vujosheviq: *Mbyll sytë*

Hesus Gonzales Rubio: *Kapelat meksikane*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin *Mbyll sytë* dhe identifikojnë interpretuesit —zërin solo me shoqërim të korit. Kujtojnë konceptet-termat e njohur si kori dhe dirigjenti (udhëheqësi) i korit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin audio të këngës dhe vërejnë se interpretimi i solo zërit dhe korit shoqërohet nga një grup instrumentesh. Me ndihmën e mësuesit/mësueses, nxënësit dhe nxënëset nxjerrin përfundimin se grupi i interpretuesve që luajnë së bashku në instrumente quhet orkestër.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset vëzhgojnë me vëmendje këngën e numë-

rimin *Orkestra* dhe analizojnë tekstin. Lidhin tekstin e këngës së numërimit me jetën dhe aktivitetet e përditshme. Mësuesi/mësuesja ekzekuton këngën e numërimit pjesë-pjesë, nxënësit dhe nxënëset e ndjekin duke artikuluar qartë tekstin dhe duke përdorur elementë shprehës. Përsërisin derisa ta performojnë-ekzekutojnë saktë dhe qartë.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesi/mësuesja u ndan nxënësve instrumentet ritmike nga instrumentariumi Orf. Nxënësit dhe nxënëset krijojnë dhe ekzekutojnë shoqërimin ritmik për këngën e numërimit duke përdorur metrikën (pjesët e takteve të theksuara dhe të pathek-suara).
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin *Kapelat Meksikane*, komentojnë përjetimin e tyre pas dëgjimit dhe krijojnë një koreografi me ndihmën e mësuesit/mësueses.

Pianisti

(M. Matanoviq)

Kur e u - lë tas - tin, at' - her' bën' mu - zi - kë.

5 kush po i prek tas - tet? Kush lu - an n'pi - a - no?

9 py - e - tja është e lehtë, tash të tre - goj se si,

13 me - lo - dit' e pa - qes, pi - a - nist' - i lu - an.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngën e numërimit, duke e interpretuar në formë të folur (parlato) dhe të kënduar (në dy tone), si dhe duke përdorur elementë shprehës.
- të luajë në instrumente ritmike nga instrumentariumi i Orfit.

Rrjedha e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënësjet dëgjojnë një kompozim me detyrë që të njohin instrumentin. Pasi njohin-identifikojnë pianon, përforcojnë sërish njohuritë e fituara rreth strukturës (pjesëve) së pianos dhe ngjyrës së tonit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënësjet lexojnë tekstin e këngës së numërimit "Pianisti" dhe më pas e analizojnë atë. Arrijnë në përfundimin se pianisti/pianistja është personi që luan në piano.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja këndon këngën e numërimit në dy tone. Nxënësit dhe nxënësjet dëgjojnë me vëmendje interpretimin, shikojnë shënimin grafik në libër dhe vërejnë se këtë këngë të numërimit e këndojmë në lartësi të ndryshme, në dy tone.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Vijon përpunimi i këngës së numërimit sipas procedurës metodike të parashikuar.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/mësuesja ndan nxënësit dhe nxënësjet në dy grupe dhe u ndan instrumentet nga instrumentariumi i Orfit. Një grup mund të luajë në tambure (daulle të vogla), ndërsa tjetri në shkopinj. Nxënësit dhe nxënësjet, me ndihmën e mësuesit/mësueses, krijojnë ritmin për këngën e numërimit.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Vijon loja *Pianot e gëzuara*.

Përshkrimi i lojës:

Në lojë marrin pjesë të gjithë nxënësit dhe nxënësjet: shitësi/shitësja i/e pianove, blerësi/ja dhe "pianot". Kur blerësi hyn në dyqan, shitësi/shitësja lavdëron pianot e tij/saj, pastaj i propozon blerësit që të provojë vetë se si luajnë pianot. Blerësi luan-kalon gishtat mbi tastierë (mund të jenë tastiera imagjinare ose tastiera e ngjitur mbi gjunjët e fëmijës). Ndërsa blerësi luan në "piano", shpik melodi. Kur blerësi të ketë provuar të gjitha pianot, ai vlerëson se cila piano luan

më bukur dhe e blen atë.

Kompozitori/Kompozitorja

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

— të përmendë dallimin midis dirigjentit/dirigjentes dhe kompozitorit/kompozitores, orkestrës dhe instrumentit.

Incizimi (shënime tingullore):

V. A. : *Muzikë e vogël nate*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Në fillim të orës, nxënësit dhe nxënëset lexojnë në libër pyetjen plotësuese, ku përgjigjja është kompozitori.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin *Muzika e Natës së Vogël* të V. A. , me detyrë të njohin interpretuesit. Nxënësit dhe nxënëset njohin disa instrumente dhe përfundojnë se kompozimin e interpreton orkestra. Mësuesi/mësuesja shpjegon se veprat muzikore i shkruajnë muzikantë të shkolluar, të cilët i quajmë kompozitorë. Shembulli muzikor që dëgjuam është shkruar nga një nga kompozitorët më të rëndësishëm, V. A. , i cili ishte edhe pianist i shkëlqyer.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja tregon fakte interesante nga jeta e tij dhe u kërkon nxënësve dhe nxënësve të shikojnë fotografinë e kompozitorit në libër.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesi/mësuesja informon nxënësit dhe nxënëset se në të kaluarën kanë kompozuar edhe gratë. Një nga kompozitorët dhe pianistët më të njohura ishte Klara Shuman, e cila luante veprat e tij me lehtësi të jashtëzakonshme. Nxënësit dhe nxënëset shikojnë fotografinë e Klara Shumanit në libër.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë incizimin-regjistrimin video të interpretimit të V. A. , *Muzikë e vogël nate*, ku vërejnë dirigjentin, krahasojnë dhe shpjegojnë rolin e dirigjentit dhe kompozitorit.

Gjeje kush është?

(A. Filipoviq)

Ai ne rit - min na e tre - gon, or - kes - trën kur e di - ri - gjon,
5 e kur s'ësh - të shum' nga - dal', bash - ko - het dhe ko - ri mbar'
9 her' është shpejt', e her' nga - da - lë, ndo - një - he - rë dhe me - sa - tar',
13 or - kes - tra është bend i madh, kur u - dhë - heq' një'

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të dijë dallimin midis dirigjentit dhe kompozitorit, orkestrës dhe instrumentit,
- të ekzekutojë këngë të numërimit duke e interpretuar në formë të të folurit (parlato) dhe të kënduar (në dy tone), si dhe duke përdorur elementë shprehës.

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset përsërisin njohuritë e fituara rreth koncepteve: orkestër, kompozitor, kor.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesi/mësuesja lexon tekstin e këngës së numërimit, me detyrë që nxënësit dhe nxënëset ta plotësojnë atë. Ata shkruajnë fjalën *dirigjent* në vendin e duhur në libër dhe pastaj shpjegojnë kuptimin e fjalës.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Vijon përpunimi i këngës së numërimit në dy tone. Kënga e numërimit e mësuar mund të ekzekutohet nga nxënësit dhe nxënëset së bashku me shoqërimin në instrumentet ritmike të instrumentariumit Orf, ose duke përdorur trupin si burim tingulli.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit luajnë lojën "DIRIGJENTI".

Përshkrimi i lojës:

Mësuesi/mësuesja lëshon muzikë artistike, ndërsa një nxënës ose nxënëse luan rolin e dirigjentit/dirigjentes. Nxënësit e tjerë luajnë rolin e interpretuesve të ndryshëm. Kur muzika fillon, dirigjenti/dirigjentja drejton interpretuesit, të cilët duhet me lëvizje të imitojnë instrumentet, shpejtësinë dhe fuqinë e interpretimit. Ai interpretues që ngec në ekzekutim, eliminohet nga loja.

2. THESARI POPULLOR

Duke ecur pranë Luboviqit (këngë popullore nga Mali i Zi)

$\text{♩} = 80$
Cm Cm Fm Cm

Du - ke e - cur pra - në Lu - bo - vi - qit,

5 Fm G Cm G

Bi - e vaj - za në da - shu - ri me dja - lë.

9 Cm Cm Fm Cm

Da - shu - ro - het, s'ësh - të sha - ka e vo - gël,

13 Fm Cm G Cm G

Dhe - i prem - to - i da - shu - rin' e saj.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore në diapazon prej pesë tonesh,
- të formojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje), duke korrigjuar intonacionin gjatë interpretimit.

Incizimi (shënime tingullore): Përpunimi xhaz i këngës *Duke ecur pranë Luboviqit* në interpretim të Marija Bozhoviq.

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin me një këngë të njohur, duke korrigjuar intonimin gjatë këndimit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset ndjekin me vëmendje muzikën dhe tekstin e

këngës *Duke ecur pranë Luboviqit*. Mësuesi/mësuesja shpjegon se mali Luboviq ndodhet në Podgoricë dhe se kënga përshkruan dy të rinj që u dashuruan. Nxënësit dhe nxënëset kuptojnë se bëhet fjalë për një këngë popullore, analizojnë tekstin dhe vërejnë lidhjen midis rrokjeve, fjalëve dhe frazave me melodinë.

3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja këndon këngën *Duke ecur pranë Luboviqit*, pastaj e përpunon sipas metodës së mësimi me anë të veshit - me dëgjim. Kur kënga mësohet, nxënësit dhe nxënëset e interpretojnë individualisht ose në grup.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë përpunimin-versionin xhaz të këngës në interpretimin e këngëtares malaziasë Maria Bozhoviq. Pas dëgjimit të këtij shembulli, ata krahasojnë dy interpretimet e ndryshme të këngës. Me ndihmën e mësuesit/mësueses përfundojnë se në këtë shembull dëgjuan trombonin, kitarën, bateritë, që përdoren në lloje të ndryshme të muzikës. Mësuesi/mësuesja shpjegon se shembulli i dytë i përket muzikës popullore që quhet xhaz, për të cilën do të mësojnë më tepër në klasat e larta.

Roza thurte

(këngë popullore nga Mali i Zi)



Roza nënës po i thoshte,

hajde, hajde topçe,

hajde, hajde qengji.

"Më marto, moj nëna ime!"

hajde, hajde topçe,

hajde, hajde qengji.

"Do t'martohesh, do t'pendohesh!"

hajde, hajde topçe,

hajde, hajde qengji.

Rezultatet e të nxënësit

Gjatë procesit të mësimi nxënësi/nxënësjë do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore në diapazon prej pesë tonesh,
- të lidhë tekstin e këngës me melodinë,
- të luajë në instrumente ritmike nga instrumentariumi i Orfit,
- të njohë me dëgjim zërin e fëmijës dhe të të rriturve (zë mashkullor dhe femëror).

Incizimi (shënime tingullore): Kënga popullore

Rosa thurte nga tufë kënga IX me dorëshkrime të S. St. Mokranjac.

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin duke kënduar një këngë të njohur popullore.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Rosa thurte*. Ata shikojnë tekstin e këngës në libër, e analizojnë dhe vërejnë fjalë të panjohura (p.sh. *flok't* e *ar-të*, refreni *hajde, hajde...* etj.). Konfirmojnë se është këngë popullore nga Mali i Zi.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Vijon përpunimi i këngës sipas metodës së mësimimit me anë të veshit. Nxënësit dhe nxënëset këndojnë dhe në shënimin grafik lidhin ndryshimet e rrokjeve të tekstit me lëvizjet e melodisë.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesi/mësuesja u ndan nxënësve dhe nxënëseve instrumente ritmike nga instrumentariumi i Orfit (rraketake, tambure, shkopinj, zile), kurse nxënësit dhe nxënëset krijojnë shoqërimin ritmik për këngën e mësuar me ndihmën e mësuesit/mësueses që i shtyn dhe udhëzon duke goditur pjesën e parë të taktit.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës *Rosa thurtenga* Tufë kënga IX me dorëshkrime të S. St. Mokranjac. Mësuesi/mësuesja i ndihmon të kuptojnë se është e njëjta këngë që ata mësuhan në orën e tanishme dhe t'i njohin me dëgjim interpretuesit — zërin e fëmijës ose të të rriturve, zërin e solistit ose zërat në kor.

Kërcimtarja

(Këngë popullore nga Bosnja dhe Hercegovina)

$\text{♩} = 100$

Po kër - cej - më kë - të va - lle, a - ha - ha, kë - të va - lle,

5 e - he - he, kë - të va - lle, haj - haj - haj.

Këtë valle kërcimtare, a-ha-ha, kërcimtare,

e-he-he, kërcimtare, haj-haj-haj.

T'shohim kush kërcen më mirë, kush më mirë,

e-he-he, kush më mirë, haj-haj-haj.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore në shtrirje-diapazon prej pesë toneve,
- të interpretojë kërcimin popullor *Kërcimtarja* duke respektuar ritmin dhe tempin,
- të luajë në instrumente ritmike nga instrumentariumi i Orfit.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga popullore *Kërcimtarja*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin me këngën *Duke ecur pranë Luboviqit*, bisedojnë për krijimtarinë popullore, pasuritë dhe ndryshueshmëritë e popujve që jetojnë në Mal të Zi. Rikujtojnë këngët popullore të njohura.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën popullore *Kërcimtarja*. Analizojnë tekstin dhe konstatojnë se ajo vjen nga Bosnja dhe Hercegovina.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi metodik i këngës me anë të veshit.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë në YouTube koreografinë e SH-KA-së dhe mësojnë koreografinë sipas hapave të dhënë.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/mësuesja u ndan nxënësve dhe nxënëseseve instrumente nga instrumentariumi i Orfit sipas zgjedhjes (rraketake, tambure-daulle të vogla, shkopinj, zile). Nxënësit dhe nxënëset krijojnë dhe interpretojnë shoqërimin ritmik të këngës së mësuar, me ndihmën e mësuesit/mësueses, i cili/e cila i inkurajon dhe jep ritmin duke duartrokatur kohën e parë të taktit.

Ninanana

(këngë popullore nga Shqipëria)

Moderato

Ni - na na - na po - t' për - kun - di, dja - lin
Ni - na na - na lju - ljam mo - ga si - na
5
tem po e merr - ka gu - mi.
san ga hva - ta, na - na ni - na.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimet nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore në diapazon prej pesë tonesh,
- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozicionit,
- të përdorë vizatime, lëvizje ose tregime për të shprehur/përshkruar mendimet, imazhet dhe ndjenjat personale lidhur me shembuj muzikorë të përshtatshëm për moshën.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga popullore *Ninanana*

Natën e mirë, fëmijë (nga kanali YouTube)

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bisedojnë për temat e këngëve të fëmijëve dhe tregojnë se ato shpesh trajtojnë: lojën, prindërit, shokët, kafshët. Shpjegojnë se këngët e fëmijëve zakonisht kanë temp më të shpejtë, ritëm lëvizës (të gjallë), këndohen herë me zë të qetë e herë me zë të lartë. Gjithashtu, përshkruajnë llojin e veçantë të këngëve që këndohen për fëmijët para gjumit, para se të flenë, të cilat janë zakonisht të buta, me melodi të qetë, të ngadalta dhe të heshtura për shkak të qëllimit të tyre.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Ninanana* me detyrë që të dallojnë se për çfarë lloj kënge bëhet fjalë. Ata njohin këngën e djepit-ninullën dhe shpjegojnë si kanë arritur në këtë përfundim.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja lexon këngën, ndërsa nxënësit dhe nxënëset pas dëgjimit të kujdesshëm, vërejnë se kënga është shkruar në gjuhën shqipe.
- Hapi/aktiviteti i katërt:** Vijon përpunimi metodik i këngës sipas procedurës me anë të veshit.
- Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Natën e mirë, fëmijë*, njohin zërat dhe instrumentet e rrëfejnë tekstin e këngës. Me fjalë, vizatim ose lëvizje përshkruajnë mendimet dhe ndjenjat personale. Për shembull, krijojnë lëvizje të lehta dhe lëvizin në përputhje me melodinë dhe tekstin e këngës.

Në qytetin Budim

(këngë popullore nga Serbia)

$\text{♩} = 120$

C G C G C G

mf

11 C G C

Në qy - te - tin Bu - dim mre - ku - lli e çu - di - të - shme.

Hm, hm vër - tet', mre - ku - lli e çu - dit - shme!

Miu mbolli farat në ar' të iriqit.
 Hm, hm a është vërtet', në ar' të iriqit!
 Meli është rritur, deri n'gjunj të miut.
 Hm, hm a është vërtet', deri n'gjunj të miut!
 Miut deri në gjunj, bretkut deri në krah.
 Hm, hm a është vërtet', bretkut deri në krah!

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimet, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore në diapazon prej pesë tonesh,
- të lidhë tekstin e këngës me melodinë,
- të luajë në instrumente ritmike të instrumentariumit Orf,
- të njohë me dëgjim zërin e fëmijëve dhe të të rriturve (zërat mashkullorë dhe femërorë).

Incizimi (shënime tingullore): Kënga popullore *Në qytetin Buda*

nga S. St. Mokranjac, tufë kënga e dytë

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë një këngë të njohur popullore (sipas zgjedhjes). Diskutojnë për temën e këngës së kënduar.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me kujdes këngën *Në qytetin Buda*. Më pas analizojnë tekstin dhe vërejnë se është një këngë me humor.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Vijon përpunimi metodik i këngës sipas procedurës me anë të veshit. Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me kujdes këngën dhe lidhin rrokjet e tekstit me melodinë.
- Hapi/aktiviteti i katërt:** Pasi kënga mësohet, nxënësit dhe nxënëset krijojnë ritmin në instrumentet e Orfit sipas zgjedhjes.

5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Në qytetin Budan* ga tufë kënga e dytë e S. St. Mokranjac, me detyrë që të njohin interpretuesin/interpretuesit. Mësuesja/mësuesi i udhëzon dhe drejton nxënësit dhe nxënëset drejt konkluzionit se këngën e këndojnë më shumë zëra (kor i përzier, kor i të rriturve), në dallim nga kënga ku dallohen zëri i fëmijës dhe ai i të rriturit. Nxënësit dhe nxënëset vërejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis këngës që kanë kënduar dhe asaj që kanë dëgjuar, ndërsa mësuesja/mësuesi njofton se kënga popullore i ka shërbyer S. S. Mokranjcit për të shkruar një kompozim që interpretohet nga më shumë zëra (kori).

A i keni dëgjuar këto?

(Këngë popullore nga Kroacia)

$\text{♩} = 80$

Ka - li ka mbreh ka - rroc - je - rin, kur - se lep' - ri qen lesh - ver - dhin.

5
o - ho - ho, o - ho - ho, ke - ni dë - gju - ar për k'to?

Zogu mëson pulën tonë

Bari kullot lopën tuaj.

O -ho-ho, o-ho-ho,

ke-ni dë-gju-ar për k'to?

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike individualisht dhe në grup, me diapazon prej pesë tonesh në taktin 2/4 dhe 3/4,
- të formojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje), duke korrigjuar intonacionin gjatë interpretimit.
- të luajë në instrumente ritmike të instrumentariumit Orf.

Incizimi (shënime tingullore): kënga popullore *A i keni dëgjuar këto?*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin duke kënduar një këngë popullore të njohur (sipas zgjedhjes). Diskutojnë për ngjarjen, kohën dhe vendin e krijimit të saj.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *A i keni dëgjuar këto?* dhe më pas analizojnë tekstin në libër. Vërtetojnë se kënga është popullore dhe vjen nga Kroacia. Mësuesi shpjegon fjalët e panjohura në tekst: “karrocieri” (personi që drejton karrocën) dhe qen leshverdi (një lloj qeni leshatak). Vërejnë që teksti i këngës ka natyrë gazmore.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës sipas metodës së mësimin me anë të veshit - me dëgjim. Pasi të mësohet kënga, nxënësit dhe nxënëset këndojnë individualisht dhe në grup.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën në YouTube dhe më pas

njohin instrumentet që dëgjohen në këngë (pianon dhe rraketaket).

5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/mësuesja do të ndajë instrumentet e Orfit – rraketaket dhe trekëndëshin (trianglin), ndërsa nxënësit dhe nxënëset vërejnë ritmin (shenjat më të mëdha dhe më të vogla). Me ndihmën e mësuesit/mësueses, ata interpretojnë ritmin në pjesën e tekstit “o-ho-ho” në triangle, ndërsa pjesën tjetër të këngës e luajnë me rraketake.

3. KËNDOJMË PËR NATYRËN DHE SHOQËRINË

Këngë numërimi e vjeshtës

(A. Filipoviq)



Nu - më - ru - am dar - dhat, kumb' - llat, në kopsht te I - va e vo - gël.

5
Gjysh - ja ga - ton re - çe - lin, plot do t'ke - mi n'ta - vo - lin',

9
që gjith - çka të shko - jë mi - rë, lën - gje plot e ëm - bël - si - rë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të ekzekutojë këngë numërimi duke e interpretuar në formë të të folurit (parlato) dhe të kënduar (në dy tone), si dhe duke përdorur elemente shprehëse.
- të luajë në instrumente ritmike të instrumentariumit Orf;
- të tregojë/përshkruajë (narrativisht) mendimet, imazhet dhe ndjenjat personale në lidhje me shembujt muzikorë të dëgjuar, duke përdorur vizatime, lëvizje ose fjalë (komunikim).

Incizimi (shënime tingullore): A. Vivaldi – *Vjeshta*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset diskutojnë për stinët e vitit, komentojnë ardhjen e vjeshtës dhe përshkruajnë ndryshimet në natyrë si dhe frutat e arta që ajo sjell.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Analizojnë tekstin e Këngës së numërimi të vjeshtës nga libri.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja interpreton lojën-këngën e numërimit në dy tone, duke artikuluar qartë tekstin, përdor elementë shprehës dhe lëvizje melodike të zërit në dy tone. Nxënësit dhe nxënëset përsërisin lojën-këngën. Mësuesi i kushton vëmendje të veçantë theksimit të drejtë të fjalëve gjatë shqiptimit të tekstit.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesi do t'u ndajë nxënësve instrumentet ritmike (shkopinj dhe triangle). Sipas instrumentit të marrë, nxënësit ndahen në dy grupe. Një grup interpreton ritmin me triangle, ndërsa grupi tjetër me shkopinj. Grupi me triangle ekzekuton ritmin kur të paraqitet toni "mi", kurse grupi i dytë me shkopinj kur të paraqitet toni "do". Me ndihmën e mësuesit/mësueses, ata zbatojnë metrikën muzikore duke u përqendruar në pjesët e theksuara dhe të patheksuara të takteve.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me vëmendje veprën muzikore "Vjeshta" nga A. Vivaldi. Detyra e parë është të identifikojnë interpretuesit (orkestrën me harqe-harkorët). Pasi t'i kenë dalluar-njohur ato, dëgjojnë shembullin edhe një herë me detyrë që gjatë dëgjimit të mendojnë për karakterin e veprës. Nxënësit dhe nxënëset shprehin me fjalët e tyre se kanë njohur ndjenja melankolike. Mësuesi/mësuesja tregon ilustrime në kontrast, ndërsa nxënësit dhe nxënëset zgjedhin atë që paraqet vjeshtën dhe argumentojnë zgjedhjen e tyre. Mësuesi/mësuesja shkruan në tabelë titullin e veprës dhe emrin e kompozitorit. Nxënësit dhe nxënëset vizatojnë/pikturojnë përjetimin e tyre mbi veprën e dëgjuar.

Kënga e vjeshtës

(V. Stojanov)

$\text{♩} = 60$

Dm Dm Gm Dm

Qe - të, qe - të bi - en' gje - thet e ver - dha.

5 Dm Dm Gm Dm

Kan' mbu - lu - ar rru - gët e shti - gjet në pyll.

9 A Dm A Dm

E - ra për - shkon de - gët por si në ën - dërr.

13 A Dm A Dm

Një pa - qe e bu - të ësh - të në kët' pyll.

Ikën të gjith'zogjtë larg atje në jug,
i pret rrug' e gjatë, me diellin jan' zhduk'.
Këngë nuk dëgjojmë, gjithkund ka qet'si,
vetëm gjethe t'verdha, kudo ran' në sy.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë solo dhe në grup këngë popullore dhe artistike në diapazon prej pesë toneve në takt 2/4 dhe 3/4;
- të interpretojë këngën duke respektuar elementët shprehës: tempin (i shpejtë – i ngadalshëm),
- dinamikën (qetë – fortë/zëshëm);
- të formojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje), duke korrigjuar intonacionin gjatë interpretimit.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike *Kënga e vjeshtës*

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja nis bisedën me nxënësit për stinët e vitit, diskutojnë për ndryshimet në natyrë, frutat që na dhurohen dhe si ndihemi për këto ndryshime.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Ndiqet ngrohja e zërit dhe përpunimi i këngës "Kënga e vjeshtës"

sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit.

3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë këngën dhe vërejnë lëvizjet melodike. Përshkruajnë me lëvizje të duarve kur melodia ngjitet lart (ngrenë duart) dhe kur zbret (ulin duart). Më pas, mësuesi/mësuesja u kërkon që në këndimin tjetër të bëjnë dallimin në intensitetin e tingullit/zërit – kur melodia ngrihet-ngjitet të këndojnë me një forcë zëri, e kur zbret me një tjetër. Nxënësit dhe nxënëset formulojnë intensitetin e këndimit në lidhje me tekstin dhe lëvizjen melodike.

Shtëpiza

(autor i panjohur)

Sa keq më vjen, o njeri' im,
që shtëpiza ime nuk qëndron si një trim.
Kjo shtëpiza ime vërtet s'ri drejt,
era e tund fort, ndoshta e merr krejt.
Një stuhi e fortë atë e kaploi,
E tundi fort der' sa e rrëzoi.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të interpretojë koreografi të thjeshta për lojëra;
- të njohë me dëgjim zërin e fëmijës dhe të të rriturve (zë mashkullor dhe femëror).

Incizimi (shënime tingullore): fragment nga mjuziklli *Mary Poppins* dhe kënga *Oxhaku*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset përshkruajnë shtëpinë e tyre, si dhe shtëpinë e vogël të kafshës së tyre shtëpiake.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesi/mësuesja lexon tekstin e këngës dhe shpjegon lëvizjet. Nxënësit dhe nxënëset mësojnë tekstin, përsërisin lëvizjet, dhe pasi i zotërojnë, fillojnë lojën.

Përshkrimi i lojës:

Sa keq më vjen, o njeri' im,

që shtëpiza ime nuk qëndron si një trim.

(Nxënësit/et formojnë me duar një shtëpi me çati të mprehtë, të pjerrët në anën e djathtë).

Kjo shtëpiza ime vërtet s'ri drejt, era e tund fort, ndoshta e merr krejt.

(Nxënësit rrotullojnë duart në anën e majtë.)

Një stuhi e fortë atë e kaploi,

E tundi fort der' sa e rrëzoi.

(Fryjnë në shtëpinë e bërë me duar, e kur e rrëzojnë, duart i përplasnin fort.)

3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pas përfundimit të lojës, nxënësit dhe nxënëset shikojnë fragmentin nga mjuziklli "Mary Poppins" – "Oxhaku", pastaj komentojnë dhe përshkruajnë videon e shikuar.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë të njëjtin shembull muzikor në gjuhën tonë, në interpretimin e korit të fëmijëve, duke u udhëzuar nga mësuesi/mësuesja që të njohin llojin e korit (kori i fëmijëve).

Poeti i qiellit

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 75$
Dm

N'he - shtje n'fund të di - tës, mbi fo - len' e zo - gut,

3 A A7 Dm A Dm

rre - ze t'ndrit - shme djeg' - se, që shkël - qej - në si y - je.

Me ndrojtje po kalon,
yjet po e th'rrasin,
s'bashku nëpër qiell,
lundrojn' edhe flasin.

Poeti i qiellit,
sonte udh'ton natën,
si kalorës qielli,
me yje shoqërohet.

Pas shëtitjes s'gjatë,
gjumi e kaploi,
Hëna se ç'u lodh shumë,
ditë e re filloi.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike në diapazon prej pesë toneve në taktin 2/4 dhe 3/4,
- të interpretojë këngën duke respektuar elementët shprehës: tempin (shpejt-ngadalë), dinamikën (e qetë-e fortë),
- të formojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit lart-poshtë dhe poshtë-lart (ngjitje – zbritje), duke korrigjuar intonacionin gjatë interpretimit.
- me fjalët e veta të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Poeti i qiellit*

L. van Bethoven: *Sonata e dritës së Hënës*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset zgjidhin enigmën që u parashtrohet nga mësuesi/mësuesja, ku përgjigjja është HËNA.
("Ecën natën, shkëlqen natën, / mbi jastëkun tënd hedh hijen. / Dhe derisa dielli fle i qetë, ajo ndriçon fytyrën krejt. Kush është AJO?") Më pas, të gjithë e këndojnë këngën Hëna, të cilën e kanë mësuar në klasën e dytë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi interpreton këngën *Poeti i qiellit*. Nxënësit dhe nxënëset lexojnë tekstin nga libri *Aventura e muzikës* dhe analizojnë atë, duke vëzhguar lëvizjen e melodisë përmes notave ilustruese në libër.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës *Poeti i qiellit* sipas procedurave metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit. Nxënësit dhe nxënëset e interpretojnë këngën individualisht dhe në grup.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin *Sonata e dritës së Hënës* nga L. van Bethoven. Pas dëgjimit të parë, ata identifikojnë instrumentin që interpreton veprën (pianon). Gjatë dëgjimit të dytë, vëzhgojnë karakterin e veprës – të qetë, të butë dhe të hidhur. Gjatë dëgjimit të tretë, mësuesja/mësuesi kërkon nga nxënësit që të imagjinojnë kohën e ditës (24 orësh) me të cilën do ta lidhin një shembull të tillë (nata). Mësuesja/mësuesi i njofton nxënësit me titullin e veprës, ndërsa nxënësit dhe nxënëset e ilustronjë përvojën e tyre në Ditarin e dëgjimeve.

Babi

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 80$
C G C G C G

He - ro i fë - mij' - ris' sime, ba - bi im është bu - rrë i hij - shëm,
5 ai për mu' është i rënd' - si - shëm dhe shum' i fu - qi - shëm.

Babi me ne lu'n e këndon,
zhurmën ai shumë s'e duron,
më do mua dhe vëllanë
e sidomos mamin.

Babi di të shkruaj' këngë,
të bëj tortë edhe çezme,
dhe në supe mua më ve
është mjeshtër i vërtetë.

Mezi pres që ai të vijë,
nga larg hapat ia dëgjoj,
un' at'her' jam i gëzuar,
ai aty është për mua.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje që:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike, në diapazon prej pesë toneve, në taktin-masën 2/4 dhe 3/4,
- të formësojë zërin e vet të këndimit dhe të dallojë drejtimin e lëvizjes së zërit-melodisë (poshtë-lart/ngjitje-zbritje), duke përmirësuar intonacionin gjatë interpretimit,
- të bisedojë me të tjerët si e përjeton muzikën dhe e argumenton atë.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Babi*


Kori Yjet (Zvjezdice) dhe B. Gjukanoviq: *Babi*, shuajë errësirën (YouTube)

Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit zgjidhin një enigmë që u propozon mësuesja/mësuesi, e cila ka për përgjigje: HËNA. Shiko librin e klasës së 2-të. (Ecën natën e shkëlqen natën, mbi jastëkun tënd hedh hije. Dhe derisa dielli fle i qetë, ajo ndriçon fytyrën krejt. Kush është AJO?" Pas zgjidhjes së enigmës, nxënësit këndojnë këngën Hëna, të cilën e kanë mësuar në klasën e dytë.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës *Babi* dhe më pas vëzhgojnë dhe analizojnë tekstin nga libri shkollor.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Vijnë përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit. Gjatë përpunimit, mësuesi/mësuesja i drejton nxënësit dhe nxënëset për t'u përqendruar në formësimin e zërit dhe të korrigjojnë me intonim këndimin e tyre.
- 4. Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Babi*, shuajë errësirën në interpretimin e korit të fëmijëve Yjet dhe solistes Bojana Gjukanoviq. Më pas krahasojnë mënyrën se si është përshkruar figura e babait në të dy këngët.

(M. Matanović)

♩ = 100



Ariu i verdh',
pëlqen t'bëjë shaka,
por mbi të gjitha,
ai e do mjaltin.

Miku i tij më
i mir' është' Praslini.
Tigri, kanguri e bufi,
të gjith' një ekip.

Rezultatet e të nxënimit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të formësojë zërin për këndim dhe të dallojë lëvizjen e zërit (ngjitje–zbritje), duke e korrigjuar intonativisht interpretimin,
- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike brenda diapazonit prej pesë tonesh, në taktin 2/4 dhe 3/4,
- të lidhë tekstin e këngës me melodinë.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Vini Pu*

Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bisedojnë rreth tregimit *Vini Pu*, të cilin ose nëse e kanë trajtuar gjatë orëve të gjuhës malazeze–serbe, boshnjake, kroate dhe letërsisë, dhe përmendin personazhet dhe karakteristikat e tyre. Çdonjëri përmend personazhin e preferuar dhe shpjegon pse e ka pëlqyer.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit lexojnë tekstin e këngës *Vini Pu* nga teksti mësimor dhe më pas e analizojnë.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Vijnë përpunimi i këngës sipas procedurave metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit.
- 4. Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit këndojnë këngën individualisht dhe në grupe, sipas zgjedhjes së tyre.

5. Hapi/aktiviteti i pestë: Pasi kanë përvetësuar këngën, nxënësit e interpretojnë atë duke ndjekur diagramin-shënimit vizual të paraqitur në librin mësimor dhe vërejnë lidhjen e rrokjeve dhe fjalëve me lëvizjen e melodisë.

Muzikantët e Bremenit

(M. Matanoviq)

♩ = 90

Ven - do - si - go - ma - ri që të shë - ti - së bo - tën,

5 Qe - ni i - u ba - shkë - ngjit të shkojn' bashk' si një du - et.

9 Ma - cja ta - koi pla - kun, dhe pas - taj e - dhe gje - lin,

13 Pra - në ty - re shkël - qen një ka - rri - er' plot dri - të.

17 Njer' - zit py - es - nin ve - ten çfa - rë u ra ndër - mend,

21 a - ta ka - në ven - do - sur që bash - kë të kën - doj - në.

25 La, la, la, la, la, la, la, la, la, la.

29 La, la, la, la, la, la, la, la, la.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të formësojë zërin për këndim dhe të dallojë lëvizjen e tij (ngjitje–zbritje), duke e korrigjuar intonativisht interpretimin,
- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike brenda diapazonit prej pesë tonesh, në taktin 2/4 dhe 3/4,
- të lidhë tekstin e këngës me melodinë,
- përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizimi (shënime tingullore): K. Sen-Sans: *Karnavali i kafshëve* (gomari, pulat dhe gjelat)

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Në fillim të orës, nxënësit luajnë një lojë muzikore:

Përshkrimi i lojës: Fëmijët vendosen në rreth, kurse mësuesi/mësuesja i pëshpërit çdo fëmijë në vesh emrin e një kafshe që do të imitojë (për shembull: një zog, këlysh, mace, rosak). Fëmija që do ta gjejë do të ulet në mes të rrethit me sy të mbyllur dhe thotë: "Këndo, zog!", "Këndo, mace!" ose "Këndo, këlysh!" Një nga fëmijët në rreth i përgjigjet me "cicërimë", "mjaaaau" apo "piju-piju". Fëmija në mes duhet të dallojë se kush është ai që u përgjigj.

2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit dëgjojnë tregimin "Muzikantët e Bremenit" nga Vëllezërit Grim: Një gomar plak, duke ndjerë se po i afrohet fundi, sepse i zoti është i pakënaqur me punën e tij, vendos të largohet për në qytetin e Bremenit dhe atje bëhet muzikant i qytetit. Gjatë rrugës, ai takohet me një qen, një mace dhe një gjel, të cilët ndodhen në të njëjtën pozitë dhe vendosin të shkojnë bashkë në Bremen dhe të bëhen muzikantë. Kur bie nata, vendosin të flenë në pyll. Gjeli sheh një dritë në largësi dhe të katërt shkojnë drejt saj për të gjetur strehim më të mirë. Kur mbërritën, aty gjejnë një shtëpi të pushtuar nga hajdutë duke ngrënë. Të katërtit organizohen: qeni hipën mbi gomarin, macja mbi qenin dhe gjeli mbi macen dhe fillojnë të bëjnë zhurma me tërë fuqinë-zërat e tyre: gomari pëllet, qeni leh, macja mjaullin dhe gjeli këndon fort. Hajdutët frikësohen dhe ikin, kurse katër miqtë e rinj qëndrojnë në shtëpi, gjejnë ushqim dhe flenë të qetë.

Më vonë, njëri nga hajdutët kthehet për të parë çfarë ka ndodhur. Në errësirë, ai sheh sytë e maces që i ngjajnë prushit të zjarrit. Kur afrohet, macja e gërvisht, gomari e godet me shkëlqim, qeni e kafshon dhe gjeli këndon fuqishëm. Hajduti ikën i tmerruar nga frika. Që atëherë asnjë nga ata nuk kthehet më. Kurse, katër miqtë qëndruan përgjithmonë në shtëpi, të lumtur dhe të sigurt.

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Pas tregimit të kallëzuar, nxënësit dhe nxënëset analizojnë ngjarjen. Mësuesi/mësuesja i udhëheq të përshkruajnë se në ç'mënyrë "këndonte" ose shprehej secila kafshë: gomari, qeni, macja dhe gjeli – në mënyrë lozonjare dhe gazmore.

4. Hapi/aktiviteti i katërt: Nxënësit dhe nxënëset lexojnë dhe analizojnë tekstin e këngës. Pas kësaj, vijon përpunimi i saj sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit.

5. Hapi/aktiviteti i pestë: Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin *Gomari* nga K. Sen-Sans. Gjatë dëgjimit, mësuesja/mësuesi i udhëheq që të nxjerrin vetë përfundimin se cilën

kafshë e ka përshkruar kompozitori nëpërmjet muzikës, dhe ata e shkruajnë titullin e kompozimit në vijën e dhënë mbi QR kod (teksti mësimor, f. 34). Më pas, dëgjojnë kompozimin tjetër të të njëjtit kompozitor, *Pulat dhe gjelat*, me të njëjtin detyrë – të identifikojnë përmes muzikës se cilat kafshë përshkruhen dhe ta shënojnë titullin.

Sugjerim: Mund të përgatitet një dramatizim i këngës *Muzikantët e Bremenit* dhe të realizohet si pjesë e një aktiviteti të klasës ose në ndonjë shfaqje në shkollë.

Ruaje planetin

Teksti: J. Bogojeviq-Martinoviq

Muzika: M. Papiq

Secila stinë e vitit ka bukurinë e vet,
Dimri ka fjollat e borës, kurse vera diell dhe det.
Pranvera ka dallëndyshe dhe livadhe me lule,
Vjeshta ka frutat e saj me të cilat mburret.

Viti në tërësi si një mozaik shumëngjyrësh ngjason,
Dhe çdo stinë e tij bukuritë e veta tregon.
Val't e detit që shkumbojn', gjethet që deg't i zbukurojn',
Jan' pjes' e ngjyrave të tok's që i japin buk'ri bot's.

Prandaj ruaje Planetin ku rritesh ti e jeton,
kurr mos ndalo Planetin që me admirim ti e vështroton,
Sepse je ti o fëmijë, pjesa më e bukur e tij.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimet, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të realizojë koreografi të thjeshta në lojëra me këndim,
- të improvizojë lëvizje gjatë dëgjimit të shembujve muzikorë nga përmbajtja mësimore për klasën e tretë.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Ruaje planetin*


Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset zhvillojnë një bisedë mbi ruajtjen e mjedisit jetësor, diskutojnë mënyrat se si ndotet natyra dhe çfarë mund të bëjmë për ta mbrojtur atë.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës, kurse pas dëgjimit, zhvillojnë një diskutim për tekstin dhe analizojnë përmbajtjen dhe mesazhin e saj.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën dhe me ndihmën e mësueses/mësuesit, krijojnë një koreografi që ndjek tekstin e këngës. Përjetimin e tyre ndaj këngës mund ta shprehin edhe përmes vizatimit. Gjithashtu, mund të krijojnë instrumente nga materiale të ricikluara për t'i përdorur gjatë interpretimit.

Gjyshja Marë

(autor i panjohur)

Moderato – mesatarisht



Rezultatet e të nxëniet

Gjatë mësimet nxënësi/nxënësja do të mund:

- të këndojë individualisht ose në grup këngë popullore dhe artistike në diapazon deri në pesë tone,
- të interpretojë koreografi të thjeshta në lojëra me këndim,
- të improvizojë lëvizje duke dëgjuar shembuj muzikorë nga përmbajtja shkollore për klasën e tretë.

Ecuria e orës

1. Hapi/aktiviteti i parë: Nxënësit dhe nxënëset flasin për të afërmit e tyre, gjyshin dhe gjyshen, duke përshkruar vetitë, karakteristikat, zakonet dhe sjelljen e tyre.

Mësuesi ose mësuesja i udhëheq në temën e orës dhe njofton se përmes një loje të re do të njohin një gjyshe të veçantë.

2. Hapi/aktiviteti i dytë: Nxënësit dhe nxënëset mësojnë këngën sipas procedurës metodike të përcaktuar. Pasi ta zotërojnë këngën, mësuesi ose mësuesja tregon lëvizjet përkatëse. Nxënësit dhe nxënëset mësojnë dhe praktikojnë këto lëvizje duke ndjekur koreografinë e udhëhequr dhe interpretuar nga mësuesi/mësuesja.

3. Hapi/aktiviteti i tretë: Nxënësit dhe nxënëset zbatojnë lojën.

Përshkrimi i lojës:

Nxënësit dhe nxënëset qëndrojnë në një rreth. Një nxënës ose nxënëse zgjidhet dhe qëndron në qendër të rrethit. Të gjithë nxënësit dhe nxënëset këndojnë, ndërsa nxënësi ose nxënësjja në qendër këndon vetëm një pjesë të këngës, kur të vijë radha e tij/saj.

- “Hej, në shtëpi t’vjetër te ara” — nxënësit mbajnë njërën dorë në bel dhe tjetrën mbi ballë, duke shikuar larg.
- “Atje na jeton gjyshe Mara” — tregojnë me gisht drejt vendit ku jeton gjyshja.
- “Me shtatë djem që ka” — me duar tregojnë numrin 7.
- “Pa vetulla” — mbulojnë vetullat me duar.
- “Me këso lloj kokash janë” — tregojnë kokën e madhe.
- “Me kësi lloj veshësh tërë” — tregojnë veshët e mëdhenj.
- “Me kësisoj sysh në ballë” — tregojnë sytë e mëdhenj.
- “Me këso lloj mjekrash janë” — tregojnë mjekrën e gjatë.
- “Çfarë po bëj unë tani, bëni të gjithë ju fëmijë” — nxënësi/nxënësjja në qendër këndon këtë pjesë dhe kryen një veprim të zgjedhur (kërcet me gishta-klikon, duartroket, kërcen...).
- “Gjithçka po bën ti tani, atë bëjmë ne tani” — nxënësit dhe nxënëset e përsërisin këngën dhe kryejnë veprimin që bëri nxënësi/nxënësjja në qendër.

Gjyshi

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 110$

Më të shum - tin n'bo - të e du - a gjy - shin tim,

3 mus - ta - qe të gja - ta, flo - kët e thi - njur.

5 mus - ta - qe të gja - ta, flo - kët e thi - njur.

Me të ndaj sekretet,
se thot' asnjë fjalë.
Në shëtitje më çon,
dorën ma shtrëngon.

S'len gjë me ra n'mua,
prandaj un' e dua.
Kur gjyshja më kërkon,
gjyshi mu' më mbron.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësim, nxënësi/nxënësja do të mund:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike në diapazon prej pesë tonesh, në takt 2/4 dhe 3/4;
- të interpretojë këngën duke respektuar elementët shprehës të muzikës: tempin (i shpejtë-i ngadaltë), dinamikën-ngjyrimin (qetë/butë-fort/zëshëm);
- të formojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit (lart-poshtë), duke korigjuar intonacionin gjatë interpretimit.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Gjyshi*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset flasin për lojën muzikore që kanë mësuar në orën e mëparshme. Diskutojnë për gjyshen Marë dhe e krahasojnë me gjyshen e tyre. Flasin edhe për gjyshin dhe përmendin vetitë e tyre që i duan më shumë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin audio të këngës *Gjyshi*, pastaj shikojnë dhe analizojnë tekstin në libër. Krahasojnë gjyshin nga kënga me gjyshin e tyre.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Më pas vijon përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset vizatojnë portretin e gjyshit të tyre.

Kush po këndon?

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësjë do të jetë në gjendje:

— të njohë nëpërmjet dëgjimit zërin e fëmijëve dhe të të rriturve (zë mashkullor, zë femëror).

Incizimi (shënime tingullore): shembuj për zërin e fëmijëve, meshkujve dhe të femrave, si dhe kori¹ i përzier dhe kori i fëmijëve.

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset diskutojnë për këngët e tyre të preferuara, këngët nga festivalet dhe interpretuesit. Shikojnë video-regjistrimet e këngëve të festivalet (p.sh. nga festivali “Gëzimi ynë”) dhe vërejnë solistin dhe korin.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembujt: të solo-ekzekutimeve të zërit të fëmijëve, mashkullor dhe/ose femëror, dhe identifikojnë interpretuesit. Nxënësit dhe nxënëset dallojnë këndimin solo dhe të korit të të rriturve dhe të fëmijëve.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset lidhin shembujt e dëgjuar me ilustrimin përkatës në librin shkollor dhe shkruajnë emrin e interpretuesit poshtë ilustrimit.

Zgjidhjet e “gjëegjëzës”

- Si quhet grupi i këngëtarëve? (kori)
- Si quhet kur këndon një person? (solisti)
- Sa djem ka gjyshe Mara? (shtatë)
- Kush janë muzikantët e Bremenit? (gomari, gjeli, qeni, macja)
- Cilët shokë të Vini Pu janë përmendur në këngë? (tigri, kanguri dhe bufi)
- Sipas këngës “Këngë numërimi e vjeshtës”, çfarë kemi mbledhur tek Iva e vogël? (dardha dhe kumbulla)
- Kush është poeti qiellor? (hëna)
- Si bien gjethet në këngën “Kënga e Vjeshtës”? (qetë-në qetësi)
- Kush është në këngë heroji nga fëmijëria? (babi)
- Kush në këngë ka mustaqe të gjata dhe flokë të thinjur? (gjyshi)

1 (Nga YouTube)

4. NË BOTËN E INSTRUMENTEVE

Klarineta

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërojë në mënyrë vizuale dhe dëgjimore ngjyrën e tingullit të klarinetës,
- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozimeve të ndryshme muzikore.

Incizimet (shënime tingullore): V. A. : Koncert për klarinetë në A-dur (fragment)

G. Gershvin: *Rapsodia blu* (fragment)

K. Sen-Sans: *Qyqja në thellësinë e pyllit*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembuj muzikorë dhe njohin instrumentet që kanë mësuar: violinën, pianon, flautin. Përshkruajnë pamjen dhe mënyrën e përfitimit të tingullit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ngjyrës së tingullit. Diskutojnë pamjen dhe mënyrën se si prodhohet tingulli te flauti. Konstatojnë se i takon grupit të instrumenteve frymore, pasi tingulli përfitohet duke fryrë në tub.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë fragmentin nga vepra muzikore *Koncert për klarinetë në A-dur* nga V. A. Moxart me detyrë që të njohin grupin e instrumenteve përmes timbrit-ngjyrës së tingullit. Nxënësit dhe nxënëset dallojnë se bëhet fjalë për instrument frymor. Mësuesja/mësuesi shpjegon se instrumenti që dëgjuan quhet klarinetë.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi udhëzon nxënësit dhe nxënëset që të shikojnë me kujdes instrumentin në tekstin mësimor dhe më pas ta përshkruajnë atë. Nxënësit dhe nxënëset vërejnë se klarineta përbëhet nga një tub dhe është me ngjyrë të zezë. Mësuesja/mësuesi shpjegon se gjatë luajtjes instrumenti mbahet para vetes, dhe tingulli përfitohet duke fryrë në tub dhe duke shtypur “butonët”.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë fragmentin nga vepra *Rapsodia në blu* e Xh. Gershvin-it. Përshkruajnë ngjyrën e tonit-tingullit: i përthyeshem, i fuqishëm, i errët/mbyllët; mund të tingëllojë thellë, lart, apo edhe vringëllohet.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë interpretimin e veprës *Koncert për klarinetë në A-dur* të V. A. Moxart (fragment) dhe komentojnë sjelljen e interpretuesit në orkestër: çfarë bën dirigjenti, si drejton orkestrën, si duket klarinetisti gjatë lojës, si lëvizin gishtat në klarinetë gjatë përfitimit të tingujve.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Mësuesja/mësuesi udhëzon nxënësit dhe nxënëset drejt shembullit tjetër muzikor. Ashtu siç kanë dëgjuar tashmë, instrumentet me tingullin dhe ngjyrën e tyre të tonit mund të imitojnë fenomene të natyrës, kafshë etj. Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me vëmendje veprën muzikore të K. Sen-Sans *Qyqja në thellësi-*

në e pyllit me detyrë që të njohin se kë imiton klarineta. Ata dallojnë tingullin që i ngjan zogut qyqe. Gjatë dëgjimit të dytë reagojnë me lëvizje dore në tingullin karakteristik “ku-ku” (tregojnë kërcimin e tonit teposhtë). Mësuesja/mësuesi në tabelë shkruan tingullin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit.

Violonçeli

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë në mënyrë vizuale dhe dëgjimore ngjyrën e tingullit të violonçelit,
- të përdorë vizatim, lëvizje ose tregim për të shprehur mendimet dhe ndjenjat personale ndaj shembujve muzikorë.

Incizimi (shënime tingullore): K. Sen-Sans: *Mjellma*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin Kapriço nr. 24 nga N. Paganini, njohin violinën dhe përshkruajnë pamjen dhe ngjyrën e tingullit. Përshkruajnë mënyrën e përfitimit të tingullit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin “Mjellma” të K. Sen-Sans me detyrë që të njohin instrumentet që e interpretojnë veprën. Mësuesja/mësuesi i inkurajon që të dallojnë se instrumenti me hark luan melodinë, ndërsa pianoja është përcjellëse. Shpjegohet se instrumenti i dëgjuar me hark quhet violonçel.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi udhëzon nxënësit të shikojnë me kujdes ilustrimin në tekstin mësimor dhe më pas ta përshkruajnë instrumentin. Përshkruajnë pozicionin dhe mënyrën e mbajtjes gjatë luajtjes, krahasojnë instrumentin me violinën, duke vënë re ndryshimin në madhësi, por edhe ngjashmërinë në mënyrën e përfitimit të tingullit-tonit.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë përsëri kompozicionin “Mjellma” të K. Sen-Sans me detyrë që të përshkruajnë përshtypjet. Pas dëgjimit, mësuesja/mësuesi i inkurajon që të shprehin përjetimet dhe vëzhgimet personale:
 - Si lëvizte melodia: a ishte e qetë, e butë, valë-valë, e ashpër, me ngritje dhe zbritje?
 - Përshkruaj melodinë e pianos dhe krahasoj me melodinë që luan violonçeli. (Sipas udhëzimeve të mësuesit/mësueses, nxënësit dhe nxënëset duhet të kuptojnë që pianoja luan përcjelljen me nota më të shkurtra, ndërsa violonçeli melodinë kryesore me nota më

të gjata.)

5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesja/mësuesi tregon ilustrimet e mjellmës dhe kafshët kontraste, me detyrën që nxënësit dhe nxënëset të njohin se cili ilustrim i përgjigjet veprës. Parashikohet që nxënësit dhe nxënëset të njohin se ilustrimi i mjellmës i përshatet karakterit të veprës. Mësuesja/mësuesi shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe titullin e veprës.

Nxënësit ilustronë veprën e dëgjuar në Ditarin e dëgjimit.

Harpa

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

— të njohë dhe të emërtojë në mënyrë vizuale dhe dëgjimore ngjyrën e tingullit të harfës.

Incizimi (shënime tingullore): P. I. Çajkovski: *Valsi i luleve* (fragment)

B. Smetana: *Vëlltava* (përpunim për harpë, fragment)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset, përmes lojës-daljes nga loja, përsërisin njohuritë për instrumentet që kanë mësuar. Dëgjojnë shembuj muzikorë dhe provojnë të gjejnë se cili instrument po luan; kush nuk e gjen, del nga loja. Loja vazhdon derisa të mbetet vetëm një nxënës ose nxënëse.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin *Valsi i luleve* nga P. I. Çajkovski (fragment). Vërejnë që instrumenti ka një tingull të veçantë dhe ngjyrë specifike, dhe mësuesja/mësuesi shpjegon se ky instrument quhet harpë.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë fotografinë e instrumentit në tekstin mësimor dhe, me ndihmën e mësueses/mësuesit, e përshkruajnë pamjen e tij.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin *Vëlltava* të B. Smetanës, në aranzhim-përpunim për harpë, me detyrë që të përshkruajnë ngjyrën e tingullit (e ndritshme, transparente, e butë). Shikojnë video-regjistrimin e interpretimit, përshkruajnë mënyrën e mbajtjes së instrumentit gjatë luajtjes dhe mënyrën e përfitimit të tingullit.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit zgjidhin detyrat në pjesën *Gjëegjëza muzikore*.

Miu në teatr – tregim muzikor

(A. Filipoviq)

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësim, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të bisedojë me të tjerët për përjetimin e tij/saj të muzikës dhe ta argumentojë atë,
- të njohë ngjyrën e tingullit të instrumenteve.

Incizimi (shënime tingullore): shembulli tingullor i tregimit muzikor

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bisedojnë për instrumentet që kanë mësuar deri tani. I krahasojnë me njëri-tjetrin: ngjyrën e tonit/tingullit, pamjen dhe mënyrën e mbajtjes gjatë luajtjes. Krahasojnë zërat njerëzorë: mashkullorë, femërorë dhe të fëmijëve, ngjyrën dhe ndryshimet mes tyre.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi i udhëzon nxënësit dhe nxënëset të dëgjojnë me kujdes shembullin muzikor dhe të ndjekin tregimin. Gjatë dëgjimit ndjekin ilustrimet në libër dhe përshkruajnë ngjyrën e tingullit të instrumenteve.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pas dëgjimit të shembullit, nxënësit dhe nxënëset japin mendimet e tyre, përshkruajnë tempin, dinamikën, ritmin dhe pjesëmarrësit. Diskutojnë për ndjenjat që përjetuan duke dëgjuar tregimin – frikë, lumturi, gëzim, shqetësim. Mësuesja/mësuesi përsëri lëshon tregimin muzikor, dhe nxënësit/et plotësojnë përgjigjet e tyre, shprehin mendimet dhe ndjenjat.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset në Ditarin për dëgjim vizatojnë pjesën më interesante të tregimit. Sipas dëshirës, ata krijojnë tregimin-historinë e tyre muzikore.

Miu në teatr (tregim muzikor)

Një pasdite me shi, miu i vogël Maksim u fsheh duke ikur nga bubullima. U fsheh në një cep të ndërtesës, pa ditur ku ndodhej. Papritmas, një tingull i thellë e trembi aq shumë sa u ngrit në këmbë e kërcëu nga frika. Pastaj dëgjoi tinguj të ëmbël që i mbërrinin në veshë. I njohu. Ishin tingujt e V _ _ _ _ _ (violinës). Pastaj dëgjoi tingullin e një instrumenti tjetër, më pas edhe të një tjetri, dhe më tej (instrumente me hark). Më pas dëgjoi instrumente të tjera, me tinguj solemn (instrumentet e tunxhit-instrumentet frymore prej metali).

Muzika po bëhej gjithnjë e më e fortë, më e thellë. “Çfarë po ndodh?” – pyeti Maksimi.

DysHEMEJA u dridh, zemra i rrihte fort, pikërisht në ritmin e daulleve që dëgjoreshin. Papritmas, u dëgjua një zë: “Fillojmë!” Maksimi shikoi përmes një vrime dhe pa një njeri që mbante shkopin e dirigjentit. Kuptoi se ai ishte D _ _ _ _ _ (dirigjenti). Ekzekutuesit në skenë ishin veshur në mënyrë solemne, ndërsa përballë tyre, në sallë, njerëzit ishin ulur qetësisht dhe prisnin fillimin. Maksimi më në fund e kuptoi se ndodhej në T _ _ _ _ (teatr) dhe shumë shpejt

fillonte K _ _ _ _ _ (koncerti).

“Maksim, o Maksim!” – dëgjohej zëri i shqetësuar i nënës së tij nga larg. Maksimi vrapoi nëpër skenë, u ngjit në piano, kaloi mbi pultin e notave, vazhdoi të vrapojë dhe shpejt kaloi përmes vrimës, duke lënë pas vetes një tingull të mrekullueshëm dhe melodinë e orkestrës që vazhdoi të dëgjohej për një kohë të gjatë në largësi. Kur u ulën për të darkuar, vëllezërit dhe motrat e tij e shikonin me kureshtje, ndërsa ai me zë të lartë shpalli:

“Kam përjetuar një aventurë muzikore të pabesueshme!”

5. MËSOJMË TË LUAJMË

Nëna ime (A. Filipoviq)

Për çdo na - të në - na i - me me do - rën e vet kur është terr,

5
lar - gôn ënd' - rrat e kë - qi - ja, kë - don ëm - bël mu - a më th'rrret.

9
me zë t'vet për - cjell da - shu - ri, jep për - qa - fi - me e ngroht' - si,

13
të gji - thë - ve u po - ro - sit, du - a - je në - nën që t'ka rrit.

Miu dhe pelushi

(A. Filipoviq)

Pra, dë - gjo - ni mi - u një her', shall prej le - shi kish - te ble - rë,
5 por fi - llo - i të bje - rë shi dhe e la - gu sha - llin e tij.
9 Vra - poi mi - u pa pri - tes', t'ru - aj' sha - llin me kuj - des,
13 kur shi - u të nda - loj', mi - u së - rish do të vra - poj'.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të luajë në instrumente melodike – metalofon, kambana/zile ose në notaton (në nivel elementar),
- të interpretojë këngën e numërimit duke folur-parlato dhe të këndojë (në dy tone), duke përdorur elemente shprehëse.

Përgatitja për orën: Mësuesja/mësuesi do të përgatisë për orën mësimore në karton të madh (ose ndonjë mbështetje të ngjashme) pllaka të vizatuara të notatonit/metalofonit. Fushat duhet të jenë mjaft të mëdha në mënyrë që nxënësit dhe nxënëset të mund të kërcejnë mbi to, si në lojën “shkolla”. Në pllaka janë të shkruar emra dhe terma-koncepte të ndryshme – DOrë, RENata, Milani, FATima, SOListi, LABeati ose LAMa, Sldorela ose Slrena, DOrmatja ose DOrë, dhe janë ngjyrosur me ngjyra të ndryshme. (Emrat e toneve janë shkruar që nxënësit dhe nxënëset t’i mbajnë mend vizualisht dhe t’i lidhin, kur në klasën e katërt të mësojnë shkallën C-dur).

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë rregullat e lojës, të cilat shpjegohen nga mësuesja/mësuesi, dhe me ndihmën e këngës së numërimit-këndimit për ndarjen e lojës zgjidhet pjesëmarrësi i parë në lojë. Kur përmendet një emër ose term-koncept që ndodhet në prapavijë, nxënësi ose nxënësja kërcen drejt atij emri/koncepti. Gjatë kërcimit të nxënësve/nxënësive, mësuesja/mësuesi i shoqëron duke luajtur në instrument.


Loja përfundon kur të gjithë nxënësit dhe nxënëset, që dëshirojnë, marrin pjesë të paktën një herë.

2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset, përmes bisedës, shprehin vëzhgimet e tyre për lojën (disa pllaka janë më të gjata, disa më të shkurtra; disa prodhojnë tinguj më të thellë, të tjera më të lartë; kanë ngjyra dhe emra të ndryshëm). Mësuesi ose mësuesja i udhëzon nxënësit që të shikojnë ilustrimin në libër, ku do të dallojnë një paraqitje që korrespondon/përputhet me fushat e lojës që sapo luajtën.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset vëzhgojnë me kujdes ilustrimin e metalofonit në libër dhe pllakat në instrument. Mësuesi ose mësuesja ua shpërndan instrumentet nxënësve dhe ata krahasojnë ngjyrat e metalofonit me ato të ilustrimit në libër.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë shënimet muzikore të këngëve në këtë kapitull të librit dhe vërejnë ngjyrat e ndryshme të përdorura. Mësuesi ose mësuesja shpjegon se simbolet për interpretim janë vendosur në hapësirën ku shkruhen notat, dhe më pas tërheq vëmendjen te pllakat e metalofonit në libër, duke i krahasuar me pllakat e instrumentit që kanë para vetes. Ai/ajo shpjegon mënyrën e interpretimit: kur nxënësit shohin një simbol me ngjyrë blu, duhet të luajnë pllakën blu (tonin “sol”), e kur shohin simbol me ngjyrë të verdhë, duhet të luajnë pllakën e verdhë (tonin “mi”). **Nxënësit vërejnë se tonet janë me lartësi të ndryshme. (Ngjyrat në metalofon janë sipas metodës *Rainbow*.)**
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset, me ndihmën e mësuesit ose mësueses, interpretojnë këngë me dy tone duke përdorur ngjyrat/simbolet që janë prezantuar/paraqitur në libër.

Vërejtje: Parashikohet që çdo kabinet i lëndës Kulturë muzikore të ketë instrumente melodike (notaton, metalofon kromatik ose kambana). Nxënësit e klasës së tretë mësojnë të luajnë këngë me dy tone.

Plak prej bore

(A. Filipoviq)



Plak prej bo - re ke shum' ha - lle, po vjen ve - ra, dim - ri i - kën nga - dal'.

Die - lli ve - rës shum' po nxe - në, kur të fshi - het çfa - rë do të bë - jë?

ret' e vog - la pësh - pë - ri - sin, i da - shur plak bo - re ve - ra nuk qesh.

Fshi - je dhim - bjen që ke ti, ik sa më shpejt' në pol t' ve - ri - ut.

Rezultatet e të nxënimit

Gjatë procesit të mësimimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të recitojë këngë me dy tone, duke përdorur elemente shprehëse;
- të luajë në instrumente melodike – metalofon kromatik, kambana ose në notaton (në nivelin bazë);
- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozimeve të ndryshme.

Incizimi (shënime tingullore): A. Vivaldi: *Dimri*

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset përgjigjen në pyetjen e enigmës: “Çfarë është dimri (nuk ka dhëmbë, por përsëri kafshon)?” Ata bisedojnë për këtë stinë dhe shpjegojnë pse e duan dimrin: për shkak të borës, skive, slitave-tërheqjes me sankë, lojës me dëborë, Vitit të Ri, dhe plakut prej dëbore.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë mësuesen/mësuesin kënduar këngën e numërimit me kujdes dhe qartësi. Më pas ata e përsërisin duke artikuluar mirë tekstin dhe duke përdorur elementë shprehës, përfshirë lëvizjet e zërit në dy tone.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset marrin instrumente melodike dhe shikojnë shënimin muzikor të këngës në libër. Ata vërejnë ndryshimet krahasuar me këngët e mëparshme që kanë luajtur (tonet janë në pozicione të ndryshme dhe kanë ngjyra të tjera). Mësuesja/mësuesi tërheq vëmendjen e nxënësve ndaj këtyre ndryshimeve të

pllakave me ngjyra të metalofonit në tekstin mësimor dhe i krahasojnë me pllakat në instrumentin që kanë përpara. Kur shohin imazhin/simbolin me ngjyrë të gjelbër, luajnë në pllakën me ngjyrë të gjelbër (fa), ndërsa kur shohin simbolin me ngjyrë të verdhë, luajnë në pllakën me ngjyrë të verdhë (mi). Mësuesi ose mësuesja, duke krahasuar vendin e tingullit në pentagram, i drejton nxënësit drejt përfundimit se tingujt janë me lartësi të ndryshme. Nxënësit praktikojnë të luajnë këngën.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin “Dimri” nga A. Vivaldi, me detyrë të njohin interpretuesit (orkestrën me harqe). Gjatë dëgjimit të dytë, vërejnë tempin dhe dinamikën, përshkruajnë se si ato ndikojnë në mendimet dhe ndjenjat e tyre, dhe shprehin përshtypjet e tyre. Mësuesi ose mësuesja gjatë dëgjimit të tretë u tregon nxënësve dy ilustrime. Nxënësit dhe nxënëset zgjedhin atë që sipas tyre i përshtatet shembullit të dëgjuar. Pas dëgjimit, nxënësit arsyetojnë zgjedhjen e tyre.

6. HAPËSIRA PËR DËGJIMIN E MUZIKËS (DËGJIMORJA)

Zhanri muzikor

Rezultatet e të nxënit - mësimit

Gjatë procesit të mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të klasifikojë shembujt e dëgjuar sipas llojeve dhe zhanreve (artistike, tradicionale, filmike),
- të diskutojë për arsyet e shumta të krijimit të muzikës në kontekste të ndryshme (muzikë solemne, muzikë për vallëzim).

Incizime (shënime tingullore):

- Këngë popullore malazeze (Duke ecur pranë Luboviqit)
- Këngë popullore maqedonase (Vajzë maqedonase)
- Këngë popullore nga Serbia (Në qytetin Budim)
- Këngë tradicionale skoceze (shembull për gajde)
- J. Shtraus, Marshi i Radetskit
- G. F. Hendëll, Joy to the world
- Muzikë nga filmi vizatimor Mbreti i Luanëve, *Lions sleeps tonight*
- Muzikë nga filmi vizatimor Mbretëria e akullt (Frozen), *Let it go*
- Muzikë nga filmi vizatimor Bukuroshja dhe bisha, *Beauty and the beast* (Celine Dion & Peabo Bryson)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë video që paraqesin kostume popullore nga vende të ndryshme, pastaj përshkruajnë dhe komentojnë ndryshimet.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Ata dëgjojnë shembuj muzikorë: këngë popullore nga Mali i Zi, Serbia, Skocia dhe Maqedonia e Veriut. Vërejnë se disa këngë këndohen në gjuhë të ndryshme, përdoren instrumente të ndryshme dhe dallojnë nga këngët popullore malazeze dhe shqiptare. Arrijnë në përfundimin se këngët popullore të vendeve të ndryshme janë karakteristike dhe të dallueshme.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me vëmendje shembuj muzikorë dhe i përshkruajnë sipas përjetimeve/ndjesive dhe përvojës së tyre, e më pas ekze-

kutojnë lëvizjet-hapat nën muzikë.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin “Marshi i Radetskit” nga J. Shtraus. Pas dëgjimit, nxënësit dhe nxënëset përshkruajnë karakterin e kompozicionit dhe vërejnë/shpjegojnë se kjo muzikë i nxit ata për lëvizje. Pas dëgjimit të dytë, ata fillojnë spontanisht të lëvizin në ritmin e marshit.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozicionin “Gëzimi i botës” (Joy to the world) nga G. F. Hendell dhe nga shembulli i dëgjuar nxjerrin përfundimin se këndon një kor fëmijësh. Me ndihmën e mësueses/mësuesit, ata përshkruajnë karakterin solemn të veprës.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngë nga filmat vizatimorë dhe, duke ndjekur ilustrimet në tekstin mësimor, përpiqen të lidhin secilin shembull me ilustrimin përkatës. Ata përshkruajnë ndjesitë e tyre gjatë dëgjimit të shembujve muzikorë.
7. **Hapi/aktiviteti i shtatë:** Duke dëgjuar shembuj të ndryshëm muzikorë, nxënësit dhe nxënëset arrijnë në përfundimin se ekzistojnë lloje të ndryshme të muzikës. Ata konstatojnë se në fillim dëgjuan muzikë popullore, e cila këndohet me shoqërimin e instrumenteve popullore. Më pas dëgjuan muzikë artistike, e cila luhet me instrumente artistike, dhe në të shoqëruan lëvizje-hapa vallëzimi. Në fund dëgjuan shembuj muzikorë nga filmat e animuar, të cilët kanë karakter argëtues. Me ndihmën e mësueses/mësuesit, ata diskutojnë për arsyet dhe nevojën për zhanre të ndryshme muzikore.

Vërejtje: Për shkak të kompleksitetit të temës mësimore, numrit të shembujve muzikorë për dëgjim dhe realizimin e orës, sugjerohet që kjo temë të trajtohet në dy orë mësimore. Shembujt e dhënë janë propozime.

Në krahët e muzikës së filmit

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mëimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të përshkruajë me fjalët e veta karakterin e kompozicioneve të ndryshme,
- të përdorë vizatimin, lëvizjen/hapat ose rrëfimin për të shfaqur/përshkruar mendimet, imazhet dhe ndjenjat personale lidhur me shembujt muzikorë të përshtatur për moshën e klasës së tretë.

Incizime (shënime tingullore):

- Muzika nga filmi *Mary Poppins* kënga “Oxhaku”
- Muzika nga filmi vizatimor *Mbreti i Iuanëve, Hakuna Matata*
- Muzika nga filmi vizatimor *Frozen 2, Into the Unknown*

- Muzika nga filmi *Këngët e mia, ëndrrat e mia, Do, Re, Mi*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset diskutojnë për filmat vizatimorë të tyre të preferuar. Mësuesja/mësuesi tregon ilustrime nga filmat vizatimorë (teksti mësimor, f. 53), të cilat nxënësit dhe nxënëset i njohin dhe përmendin titujt. Mësuesja/mësuesi shpjegon se si krijohet muzika për një film, që kompozitori/kompozitorja e shkruan muzikën dhe shpesh disa fragmente bëhen aq të njohura, sa që ekzekutohen edhe në mënyrë të pavarur, jashtë filmit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë një fragment nga mjuziklli *Mary Poppins*. Ata e njohin shembullin (sepse e kanë dëgjuar më parë) dhe pastaj përshkruajnë atmosferën. Arrijnë në përfundimin se muzika i përshtatet ngjarjes së filmit dhe komentojnë atmosferën gazmore të fragmentit.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Në vijim të orës, nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë vepra muzikore nga filmat: *Mbreti i luanëve*, *Frozen* dhe *Këngët e mia, ëndrrat e mia*. Duke ndjekur ilustrimet në tekstin mësimor, ata përpiqen të lidhin secilin ilustrim me shembullin muzikor që dëgjojnë. Më pas, shikojnë video-klipet nga këta filma dhe vërejnë se disa shembuj janë nga filma të animuar, ndërsa disa të tjerë nga filma për fëmijë. Pas dëgjimit dhe shikimit të këtyre pikave, ata përshkruajnë përvojën e tyre gjatë dëgjimit.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset në Ditarin e dëgjimit ilustrojnë përjetimin e tyre për kompozimin që u ka pëlqyer më shumë.

LITERATURA

- Vasileviq Zorisllava, *Музички буквар* (Abetarja muzikore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, 1991.
- Vasileviq Miodrag, *Народне мелодије Црне Горе* (Meloditë popullore të Malit të Zi), Instituti i muzikologjisë, Beograd, 1965.
- Vujiçiq Branka, Dediq Ivana, Naumovski Aleksandra, *Чудесни свијет звукова 3*, (Bota e mrekullueshme e tingujve 3), Kultura muzikore për klasën e tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2005.
- Ivanoviq Nada, *Музика у основној школи* (Muzika në shkollën fillore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008.
- Iliq Vlladica, *Музичка култура за трећи разред основне школе* (Kultura muzikore për klasën e tretë të shkollës fillore), Qendra Kreative, Beograd, 2016.
- Jabllanov Nada, *Народне песме и игре за децу, родитеље, васпитаче и учитеље* (Këngë dhe vallëzime/lojëra popullore për fëmijë, prindër, edukatorë dhe mësues, botimi i dytë, Qendra Kreative, Beograd, 2006.
- Martinoviq-Bogojeviq Jellena, Papiq Millena, Durkoviç Bilana, *Чаролија музике 3*, Magjia e muzikës 3, Kultura muzikore për klasën e tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2013.
- Programi mësimor për ciklin e parë të shkollës fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2009.
- Programi mësimor i KULTURËS MUZIKORE për klasat I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollave fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2017.
- Stokoviq Petar, *Настава музичке културе* (Mësimi i kulturës muzikore), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve mësimore, Beograd, 1988.